



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri KSC-BC-2020-06
Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendos: **Gjykatësi i Procedurës Paraprake**
Gjykatësi Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi parashtrues: Prokurori i Specializuar

Data: 13 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Parashtrimet e Prokurorisë për konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes

Prokurori i Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Dejvid Hupër

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Deivid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

I. HYRJE

1. Sipas Urdhrit për mbajtjen e konferencës mbi ecurinë e çështjes,¹ Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) paraqet parashtrimet e saj me shkrim për pikat e rendit të ditës të identifikuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,² dhe për çështje të lidhur me to.³

2. Disa nga informacionet e dhëna janë detyrimisht provizore në këtë kohë. Megjithatë, ZPS-ja parashikon se do të jetë në gjendje të ofrojë listat e plota të dëshmitarëve dhe të provave materiale dhe se do të ketë përmbushur detyrimin e nxjerrjes së materialeve sipas rregullës 102(1)(b)⁴ deri më 31 maj 2021, në varësi vetëm të çfarëdo mase mbrojtëse në fuqi, dhe me kusht që procedura paraprake të jetë pranë përfundimit dhe që fillimi i gjykimit të planifikohet pak kohë më pas.

II. PARASHTRIMET

A. TEMA TË PËRGJITHSHME

3. Në këtë çështje ende janë duke u kryer një numër hapash hetimorë, duke përfshirë masat që mund të merren vetëm nëse çështja bëhet publike. Në varësi të rezultatit të këtyre hetimeve, ka gjasa që të paraqiten prova të mëtejshme. Një numër hapash të procesit varen nga bashkëpunimi apo ndihma e palëve të jashtme, apo ndryshe, përfshijnë faktorë jashtë kontrollit të drejtpërdrejtë të ZPS-së. Megjithatë,

¹ Urdhër për caktimin e datës së konferencës mbi ecurinë e çështjes dhe për parashtrimet, KSC-BC-2020-06/F00074, 11 nëntor 2020, Publik (“Urdhri për konferencën mbi ecurinë e çështjes”).

² Shtojca 1 e caktimin e datës së konferencës mbi ecurinë e çështjes dhe për parashtrimet, KSC-BC-2020-06/F00074/A01, 11 nëntor 2020, publike (“Shtojca 1”).

³ Urdhri për konferencën mbi ecurinë e çështjes, KSC-BC-2020-06/F00074, para.21(b).

⁴ Rregullorja e Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës,, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor 2020 (“Rregullorja”). Çdo përmendje e termit “rregulla” apo “rregullat” këtu i referohet Rregullores, përveç kur përcaktohet ndryshe.

ZPS-ja aktualisht nuk e parasheh këtë gjë si diçka që do të ndikojë në kryerjen e shpejtë të procesit dhe po punon për përfundimin e çdo hapi të rëndësishëm hetimor të mbetur gjatë procedurës paraprake.

4. ZPS-ja parashikon të paraqesë dëshmi shkresore, duke përfshirë, për shembull, raporte, fotografi dhe dokumente të UÇK-së së asaj kohe të tilla si urdhra, rregullore dhe/ose publikime të tjera. Një përshkrim më i hollësishëm, ndonëse paraprak, i provave që do të paraqiten jepet në pjesët B dhe C më poshtë.

5. Gjithashtu, për Aktakuzën e Konfirmuar ZPS-ja është mbështetur tek 153 dëshmitarë dhe ka për qëllim të mbështetet tek shumica e tyre përsëri në gjyq. ZPS-ja aktualisht parashikon të shtojë afërisht edhe 50 dëshmitarë të tjerë në listën e saj të dëshmitarëve, ndonëse numri përfundimtar i dëshmitarëve mund të ndryshojë, në varësi edhe të përfundimit të hapave të mbetur hetimorë.

B. RREGULLA 102(1)(A): MATERIALI MBËSHTETËS I AKTAKUZËS

6. Tabela A jep, me aq sa është e mundshme, hollësitë e kërkuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake lidhur me detajimin e materialit sipas rregullës 102(1)(a):

Tabela A. Materiali sipas rregullës 102(1)(a)

Numri i gjithsejtë i dokumenteve	1.842 (përfshirë përkthimet)
Numri i gjithsejtë i faqeve	43.108 (përfshirë përkthimet)
Numri i gjithsejtë i orëve/minutave të audio dhe videomaterialeve	20 orë, 17 minuta dhe 30 sekonda
Numri i deklaratave të dëshmitarëve	103

Numri i deklaratave të marra nga të akuzuarit	37 dokumente ⁵ (anglisht dhe shqip)
Numri i pjesëve të transkripteve (duke mos përfshirë transkriptet e të akuzuarve) ⁶	1.253
Numri i raporteve	83
Numri i audio/videomaterialeve	17
Numri i fotografive	6
Numri i gjësendeve	0
Numri i dokumenteve të tjera ⁷	343

7. Rregulla 102(1)(a) kërkon që ZPS-ja të bëjë të njohura materialet mbi të cilat mbështetet Aktakuza brenda 30 ditësh nga paraqitja e parë e të akuzuarve. Duke pasur parasysh fushëveprimin e Aktakuzës dhe vëllimin e materialeve mbështetëse,⁸ ZPS-ja kërkon afatin e plotë ligjor të kësaj çështjeje. Nëse ZPS-ja do të jetë në gjendje t'i bëjë të njohura materialet përpara afatit ligjor, ajo do ta bëjë këtë. Megjithatë, aktualisht nuk parashikohet që kjo të jetë e mundur të bëhet lidhur me asnjë pjesë të materialeve (pavarësisht nëse kërkojnë apo jo redaktim).

8. Redaktime të konsiderueshme janë të nevojshme si për materialet sipas rregullës 102(1)(a), ashtu edhe për përmbledhjen e detajuar të parashtruar sipas rregullës 86(3)(b). Këto redaktime duhet të bëhen me kujdes dhe përputhshmëri me

⁵ Transkriptet e intervistave të ZSP-së janë të ndara në pjesë dhe çdo pjesë është ngarkuar më vete në sistem.

⁶ Transkriptet e intervistave të ZPS-së janë të ndara në pjesë dhe çdo pjesë është ngarkuar më vete në sistem.

⁷ Kjo përfshin, për shembull, libra, komunikata apo deklarata politike të UÇK-së, raporte, urdhra ushtarakë.

⁸ Materialet sipas rregullës 102(1)(a) në çështjen *Mustafa* përmbajnë 1.248 faqe. Krahasuar me numrin e faqeve të pasqyruara në Tabelën A, sasia e materialit të nxjerrë sipas rregullës 102(1)(a) në këtë çështje është mbi 34 herë më shumë.

qëllim që të jenë të efektshme. Përveç sistemit të redaktimit të propozuar më poshtë,⁹ ZPS-ja do të bëjë një kërkesë për masa mbrojtëse lidhur me disa nga viktimat dhe dëshmitarët e përmendur në materialet e rregullës 102(1)(a). Kjo kërkesë do të dorëzohet brenda një jave nga përfundimi i paraqitjeve të para të të akuzuarve, sikurse është urdhëruar më herët nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

9. Përkthimi në shqip i materialeve mbështetëse të Aktakuzës (duke përfshirë deklaratat e dëshmitarëve dhe transkriptet) është duke vazhduar dhe këto përkthime do të përfundohen dhe bëhen të njohura brenda afatit ligjor 30-ditor.

C. RREGULLA 102(1)(B): MATERIAL SHITESË I SYNUAR PËR PËRDORIM NË GJYKIM

10. Përveç materialit të rregullës 102(1)(a), ZPS-ja synon në fakt të nxjerrë materiale të tjera sipas rregullës 102(1)(b). ZPS-ja pret të jetë e gatshme që t'i bëjë të njohura materialet shtesë të rregullës 102(1)(b) deri më 31 maj 2021 ose, gjithsesi, jo më vonë se 30 ditë përpara se Prokurori i Specializuar të hapë çështjen (objekt vetëm i çfarëdo mase mbrojtëse të miratuar).

11. Aktualisht është parashikuar që materiali shtesë sipas rregullës 102(1)(b) të përfshijë deklaratat/dëshmitë e afërsisht 50 dëshmitarëve të tjerë.¹⁰ Transkriptimi dhe përkthimi i deklaratave të dëshmitarëve në të cilat ZPS-ja synon të mbështetet në gjyq, do të vazhdojë pas përfundimit fillimisht të përkthimeve të materialeve të mbetura sipas rregullës 102(1)(a). Ky është një proces i ngjeshur pune që kërkon kohë, kontroll dhe rishikim të kujdesshëm.

⁹ Pjesa 2, I.

¹⁰ Shih para.4 më lart. Numri përfundimtar i dëshmitarëve (duke përfshirë vendimin nëse duhet të thirren dëshmitarë ekspertë për të dëshmuar) do të varet nga rezultatet e hapave hetimorë të kufizuar të mbetur.

12. Për sa u takon provave shkresore, ZPS-ja parashikon që të paraqesë afërsisht 1.500 prova materiale në gjyq. Ky vlerësim paraprak mund të ndryshojë në varësi të, ndër të tjera, rëndësisë së provave të marra kohët e fundit (të cilat aktualisht po përpunohen dhe rishikohen) dhe nga rezultatet e hapave të mëtejshëm hetimorë. Ka të ngjarë që provat materiale të përfshijnë prova të dhëna nga dëshmitarët gjatë intervistave, fotografi, raporte, dokumente bashkëkohëse dhe videomateriale.

13. Do të jetë e nevojshme që të bëhen redaktime të materialeve që do të bëhen të njohura së shpejti sipas rregullës 102(1)(b). Lidhur me dëshmitarë të tjerë shtesë të cilët mund të përdoren gjatë gjykimit dhe për të lehtësuar vlerësimet në vazhdim, ZPS-ja parashikon që do të dorëzojë një kërkesë të dytë për masa mbrojtëse në shkurt të 2021.

14. Ndonëse ZPS-ja synon që materialet e rregullës 102(1)(b) t'i paraqesë pjesë-pjesë kur ato të jenë gati për t'u bërë të njohura, për të siguruar një proces efikas shqyrtimi para nxjerrjes së tyre në këtë moment nuk mund të bëhen zotime për nxjerrjen e ndonjë pjese të këtyre materialeve në një datë më të hershme (si për shembull, ato që nuk kërkojnë redaktim).

D. RREGULLA 102(3): MATERIALE PROVASH PËR PËRGATITJEN E MBROJTJES, TË MARRA NGA TË AKUZUARIT, APO QË U PËRKASIN TË AKUZUARVE

15. ZPS-ja parashikon që t'i japë Mbrojtjes një njoftim të hollësishëm për materialet e provave, në përputhje me nenin 21(6)¹¹ dhe rregullën 102(3), deri më 30 prill 2021, kohë kur përcaktimi i materialeve sipas rregullës 102(1)(b) parashikohet të jetë afër përfundimit. Materialet për njoftim sipas rregullës 102(3) do të përfshijnë çdo informacion tjetër të mbetur që potencialisht mund të përbëjë material për Mbrojtjen

¹¹ Ligji nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 ("Ligji"). Çdo përmendje e termit "neni" apo "nenet" këtu u referohet neneve të Ligjit, përveçse kur përcaktohet ndryshe.

pas materialeve që do të paraqiten në gjyq¹² dhe pasi materialet potencialisht shfajësuese¹³ të jenë bërë të njohura.

16. Kuadri i materialeve sipas rregullës 102(3) domosdoshmërisht ndikohet dhe, në një masë të madhe, varet nga dëshmitarët dhe provat që synohen të paraqiten në gjyq. Si rrjedhojë nuk është e mundur të jepet një vlerësim i saktë i vëllimit të tyre në këtë kohë. Megjithatë, bazuar në shqyrtimin në vazhdimësi, ZPS-ja parashikon afërsisht deri në 100.000 dokumente sipas rregullës 102(3). Për një përqindje të konsiderueshme të këtyre dokumenteve parashihet nevoja për redaktim.

E. RREGULLA 103: PROVAT SHFAJËSUESE

17. Mbi 1.000 dokumente potencialisht shfajësues do të bëhen të njohura jo më vonë se sa materialet që mbështetin Aktakuzën. ZPS-ja do të vijojë të shqyrtojë dhe, pas redaktimeve të nevojshme, do të nxjerrë menjëherë hap pas hapi çdo material sipas rregullës 103 që ka në ruajtje, nën kontroll apo në dijeninë e vet aktuale.

18. Lidhur me dokumente potencialisht shfajësuese nga burime të hapura, Dhoma e Apelit e TPNJ/TPNR-së ka arritur në përfundimin se prokuroria çlirohet nga detyrimet e veta të nxjerrjes së materialit kur ekzistenca e provave përkatëse shfajësuese dihet dhe kur provat mund të sigurohen duke përdorur zellin e duhur.¹⁴ Ky është një kufizim i arsyeshëm i obligimeve të ZPS-së për nxjerrjen e materialit sipas rregullës 103, duke qenë se disa materiale të mirënjohura, si shpallja e pafajësisë nga TPNJ-ja për njërin prej pjesëtarëve të identifikuar me emër të NPK-së në këtë çështje,

¹² Rregulla 102(1)(b).

¹³ Rregulla 103.

¹⁴ ICTY, *Prosecutor v. Bralo*, IT-95-17-A, Decision on Motions For Access to *Ex Parte* Portions of the Record on Appeal and for Disclosure of Mitigating Material, para.30; ICTR, *Niyitegeka v. The Prosecutor*, ICTR-96-44-R, Decision on Request for Review, 30 June 2006, para.51.

janë qartësisht të njohura për të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre.¹⁵ ZPS-ja kërkon që kufizime të tilla të zbatohen edhe në këtë rast.

F. RREGULLA 107: MATERIALI I MBROJTUR

19. ZPS-ja po përpiket aktivisht të sigurojë miratimet e mbetura sipas rregullës 107 lidhur me materialet që kanë rëndësi potenciale për këtë çështje. Për më shumë se 18 muaj, ZPS-ja vazhdimisht dhe fuqimisht ka këmbëngulur për sigurimin e këtyre miratimeve dhe ka informuar institucionet përkatëse për afatet e zbatueshme dhe të parashikuara në këtë rast.

20. Në këtë fazë, nuk parashikohet që sigurimi i këtyre miratimeve do të vërë në rrezik afatet e njoftuara. Megjithatë, ZPS-ja do ta njoftojë menjëherë Gjykatësin e Procedurës Paraprake nëse ky vlerësim do të ndryshojë.

G. PËRKTHIMI I DOKUMENTEVE DHE PROVAVE

21. ZPS-ja do të sigurojë që provat e saj, përfshirë deklaratat e dëshmitarëve, të bëhen të njohura në anglishte, gjuha e punës e procesit. ZPS-ja do të japë versionet në shqip të deklaratave të të gjithë dëshmitarëve që ajo synon të përdorë në gjyq,¹⁶ dhe ka ndërmend që, në shkallën maksimale të mundshme, këto përkthime t'i paraqesë brenda afateve të njëjta të kërkuara më lart lidhur me nxjerrjen e materialeve në anglishte.

22. Korniza e DHSK-së e bën të qartë se sigurimi i përkthimeve të mëtejshme në shqip për të akuzuarit është kryesisht një çështje midis Mbrojtjes dhe Zyrës

¹⁵ ICTY, *Prosecutor v. Fatmir Limaj et al /TPNJ, Prokurori kundër Fatmir Limajt e të tjerëve*. Sa për ilustrim, pa këtë kufizim, ZPS-ja do të duhej t'ia bënte "të njohur" aktgjykimin e TPNJ-së në çështjen *Haradinaj e të tjerë*, ndër të tjerëve, një dëshmitari i cili dëshmoi në këtë çështje (Jakup KRASNIQIT) dhe kryembrojtësit të zotit HARADINAJ (Ben EMMERSON, kryembrojtësi i zotit VESELI).

¹⁶ Rregulla 102(1).

Administrative. Të akuzuarit kanë të drejtë të kenë ndihmën falas të një përkthyesi me gojë,¹⁷ dhe Zyra Administrative duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për përkthimin me gojë apo me shkrim sikurse parashikohet në Rregullore, apo urdhërohet nga paneli.¹⁸ Mbrojtësit e emëruar lejohen të dorëzojnë kërkesa për përkthim me shkrim, me gojë apo për verifikim në Zyrën Administrative.¹⁹ Në masën që nevojitet përkthimi i mëtejshëm për të akuzuarit pa mundësi financiare, shpenzimet e përkthimit me shkrim dhe me gojë janë parashikuar posaçërisht që përfshihen në honorarët e ndihmës juridike të mbrojtësve.²⁰

H. PROCEDURA E NXJERRJES SË PROVAVE

23. Sipas rregullës 109(c), për aq sa është e realizueshme palët duhet të kategorizojnë informacionin duke iu referuar veprave penale konkrete që përbëjnë bazën e tyre, elementët kontekstualë të veprave penale, veprimet e pretenduara të të akuzuarit, ose, kur është e zbatueshme, provave që do të paraqiten nga Prokurori i Specializuar. Ky kusht është përmbushur tek çështja *Mustafa* përmes përdorimit të një tablele të detajuar për nxjerrjen e materialeve.²¹ Më 12 nëntor 2020, ZPS-ja i bëri një propozim Mbrojtjes për secilin prej të akuzuarve bazuar në një format të ngjashëm si ai i miratuar në çështjen *Mustafa*. Në përputhje me këtë qasje në çështjen *Mustafa*, ZPS-ja gjithashtu ka propozuar që tabela të paraqitet pas dorëzimit të dosjes paraprake të palëve (nëse do të ketë), sepse analiza që kërkohet për përpilimin e asaj tablele, do të

¹⁷ Neni 21(4)(g).

¹⁸ Rregulla 8(4).

¹⁹ Pjesa 2 e Udhëzimit të Zyrës Administrative për parashtrimin e kërkesave për përkthim me shkrim, me gojë dhe kërkesave për verifikim, KSC-BD-14, 30 maj 2019; Pjesa 5 e Udhëzuesit për përkthime me shkrim dhe me gojë, KSC-BD-13, 15 maj 2019.

²⁰ Neni 14 i Rregullores së Ndihmës Juridike, KSC-BD-25, 3 shtator 2020.

²¹ *Shih* shtojcën 1 të Parashtrimin të përbashkët të tabelës për kategorizimin sipas rregullës 109(c), KSC-BC-2020-05/F00045/A01, *miratuar* në Vendimin mbi kërkesën e Prokurorit të Specializuar për rishqyrtim apo autorizim për apel, KSC-BC-2020-05/F00046, 5 nëntor 2020.

dalë nga ajo dosje.²² Në kohën e paraqitjes së këtij propozimi, janë duke u zhvilluar diskutime midis palëve, për të siguruar që çdo propozim të pasqyrojë në mënyrën e duhur rrethanat e kësaj çështjeje konkrete dhe për të plotësuar nevojat e palëve, por duke marrë parasysh njëkohësisht edhe kufizimet në kapacitete të secilës palë.

I. SISTEMI I REDAKTIMIT

24. ZPS-ja i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake të miratojë sistemin e redaktimit të zbatuar në çështjen *Mustafa*.²³ Në përputhje me këtë sistem, palët mund të redaktojnë informacion në materialet për të cilat kanë obligim t'i bëjnë të njohura sipas nenit 21(6) të Ligjit dhe rregullat 102-104, sipas një grupi kategorish të miratuara paraprakisht.

25. Duke u mbështetur në përvojën e grumbulluar dhe praktikën e gjykatave të tjera,²⁴ dhe në përputhje me kornizën ligjore në fuqi,²⁵ sistemi i propozuar do ta përmirësojë efikasitetin e procedurave, në veçanti, shpejtësinë e procesit të nxjerrjes së dokumenteve, duke siguruar që procedurat të kryhen duke respektuar plotësisht të drejtat e të akuzuarve dhe duke i kushtuar vëmendjen e kujdesin e duhur mbrojtjes së dëshmitarëve, viktimave dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të veprimtarisë

²² Në bazë të propozimit të ZPS-së, një përmbledhje e përmbajtjes së secilës paketë me materialet që bëhen të njohura duhet të vihet menjëherë në dispozicion në kohën e nxjerrjes së kësaj pakete përmes një kategorizimi bazë të bërë përmes Legal WorkFlow, në përputhje me kategoritë e informacionit të përcaktuar në Rregullën 109(c).

²³ Vendim kornizë për nxjerrjen e materialeve, KSC-BC-2020-05/F00034, para. 73-89.

²⁴ Shih, për shembull, for example, International Criminal Court ('ICC'), Chambers Practice Manual (December 2019), pp.31-34; ICC, *Prosecutor v. Yekatom*, ICC-01/14-01/18-64-Red, Public Redacted Version of 'Decision on Disclosure and Related Matters', 23, January 2019, paras 23-26. *See also* ICC, Chambers Practice Manual (May 2017) p.3 (duke vënë në dukje se Manuali, përfshirë sistemin e redaktimit, pasqyron praktikat më të mira bazuar në "përvojën dhe ekspertizën e gjykatësve në gjykime të ndryshme të Gjykatës") dhe f. 28-30 (ku trajtohet sistemi i redaktimit).

²⁵ Shih nenet 21(6) dhe 35(2)(f) dhe rregullat 80, 106, 108 dhe 111 (që parashikojnë përjashtimet lidhur me nxjerrjen e informacionit, ndër të tjera për mbrojtjen e personave në rrezik dhe shmangien e cenimit të hetimeve).

së gjykatës. Një redaktim i tillë gjithashtu shton aftësinë e paneleve gjyqësore në të gjitha fazat e procesit për të ushtruar në mënyrë efektive dhe efikase mbikëqyrjen e procedurës së nxjerrjes së dokumenteve, në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren. Në veçanti, sistemi i redaktimit i miratuar më herët nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake parashikon një vendim gjyqësor për çdo redaktim të kontestuar.

26. Duhet pasur kujdes se,²⁶ nuk është e nevojshme të bëhen ndryshime në sistemin e redaktimit në çështjen *Mustafa* që ai të zbatohet në çështjen konkrete, sepse në fakt çdo ndryshim i tillë do të ishte kundërproduktiv. Në pritje të një vendimi për sistemin e redaktimit në këtë çështje, ZPS-ja ka përgatitur materiale për t'i bërë të njohur, duke përfshirë redaktimin e përkohshëm në përputhje me kategoritë e miratuara nga ky gjykatës në çështjen *Mustafa*. Çdo ndryshim në këto kategori (duke përfshirë ndonjë rinumërtim) në çështjen aktuale rrezikon të shkaktojë një vonesë të konsiderueshme, meqë ZPS-së do t'i kërkohet t'u rikthehet dokumenteve të përgatitura më parë, me qëllim për të bërë ndonjë ndryshim.

Numri i fjalëve (në origjinal): 2.521

_____nënshkrim_____

Xhek Smith

Prokurori i Specializuar

E premtë, 13 nëntor 2020
Në Hagë, Holandë.

²⁶Për të shmangur nxjerrjen e të njëjtave materiale në mënyrë të panevojshme disa herë, palës nxjerrëse nuk duhet t'i kërkohet të bëjë të njohur materiale që përmbajnë redaktime të kategorisë jostandarde "E" njëkohësisht me kërkesën për leje për të bërë redaktime të tilla, përkundrazi ajo duhet të lejohet të presë sa të merret vendimi përkatës, përveç rasteve kur, duke bërë këtë, ajo do të rrezikonte afatin e zbatueshëm të nxjerrjes së materialeve (*contra*. Vendimi Kornizë për nxjerrjen e materialeve, KSC-BC-2020-05/F00034, para.88)